



AGJENCIA PËR SHËRBIME MEDIATIKE
AUDIO DHE AUDIOVIZUELE



NEWSLETTER

Maj, 2018.

Nr. 05/2018


Takim bilateral me Agjencinë rregulluese të komunikimeve të BeH



Më 17 dhe 18 maj Agjencia ishte nikoqir i përfaqësuesve të Agjencisë rregulluese të komunikimeve të Bosnjes e Hercegovinës. Kompetencat, mënyra e ndarjes së lejeve dhe kompensimet për leje për emetim, procesi i rregullimit të shërbimeve mediatike audiovizuale me kërkesë, ndryshimet e strukturës pronësore, konstatimi i koncentrimit të palejuar mediatik, ishin pjesë e temave në takimin ndërmjet dy trupave rregulluese.

Njëherë, u shkëmbyen përvojat për zbatimin e rregullave për komunikime komerciale audiovizuale në pjesën e plasimit të prodhimeve dhe sponsorisimit, aktivitetet dhe masat për sigurimin e qasjes deri te programi, për personat me pengesa në shqisa, si dhe për standardet e prezantimit të të miturve gjatë lajmeve si dhe pjesëmarrjen e tyre në programe të tjera. Vëmendje e veçantë ju kushtua edhe përvojave në drejtim të rregullativës dhe mënyrës së realizimit të monitorimit të përmbajtjeve mediatike gjatë proceseve zgjedhore.

Në fund të takimit dyditor, palët u dakorduan që gjatë vjeshtës të mbahet edhe një takim tjetër ku do të nënshkruhet memorandum për bashkëpunim, i cili do të kontribojë për zgjerimin dhe thellimin e marrëdhënieve të ndërsjella si dhe shkëmbimin e përvojave në sferën e rregullimit mediatik.



Miratohet Doracaku për mbikëqyrjen e zbatimit të konceptit programor

Agjencia për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale miratoi Doracakun për mbikëqyrjen e zbatimit të konceptit programor. Nevoja për doracakun erdhi nga mbikëqyrja e jashtëzakonshme për respektimin e nenit 67 paragrafi 6 nga LSHMAA, që potencoi se nevojitet sqarim se si të përlogaritet nëse radiodifuzeri gjatë një jave ka plotësuar 80% të konceptit programor për të cilin ka marrë leje. Debat i publik për dokumentin u realizua nga data 23 e deri më 30 prill 2018, ndërsa palët e interesuara patën mundësi që të marrin pjesë dhe të japin propozime deri te Agjencia. Doracaku për mbikëqyrjen e zbatimit të konceptit programor mund të merret në ueb faqen e Agjencisë www.avmu.mk.

Shënimi i Ditës botërore të lirisë së medimeve

Me rastin e shënimit të 3 majit - Ditës botërore të lirisë së medimeve, Agjencia theksoi se vetëm medime të pavarura, të çliruara nga presionet mund të kontribuojnë për zhvillimin e shoqërive demokratike dhe prosperuese. Liria e të shprehurit është themel i demokracive bashkëkohore, kurse vetëm përmes sigurimit të punës pa pengesa dhe të pavarur të medimeve mund të arrihet progres i caktuar. Pikërisht për këtë arsye, gazetarët, për shkak të punës së saj nuk guxojnë që të jenë shenjë e qendrave politike ose ekonomike të fuqisë. Prapë se prapë, duhet të mbahet llogari se liria e të shprehurit nuk duhet të keqpërdoret dhe se medimet kanë obligim që të respektojnë parimet profesionale dhe etike të gazetarisë. Në aspekt të gjendjes me medimet në Maqedoni, sipas raporteve të fundit të organizatave ndërkombëtare, vitin e kaluar është vërejtur një progres i vogël. Agjencia, sikur deri më tani, do të vazhdojë që të veprojë në mënyrë aktive në fushën e avancimit të standarteve profesionale dhe për rritjen e vetëdijes së vetë medimeve për rolin dhe përgjegjësinë që e kanë në shoqëri si dhe para qytetarëve.

Konstatohet mosraportim për protestën kundër ndryshimit të emrit me titull "Republika e Maqedonisë Erga Omnes"

Agjencia përmes njoftimit publik e ka informuar opinionin për konstatimin se më datë 26 prill pjesa më e madhe e televizioneve nacionale nuk kanë raportuar për protestën kundër ndryshimit të emrit, të titulluar "Republika e Maqedonisë Erga Omnes". Agjencia theksoi se medimet në mënyrë të pavarur e krijojnë politikën e tyre redaktuese, por duke marrë parasysh rolin e tyre specifik, njëkohësisht janë të obliguar që ta informojnë publikun për çështjet e rëndësishme shoqërore. Në këtë mënyrë nxitet një debat më i gjërë e që është një prej shtyllave themelore të shoqërive demokratike.

Одземе́на дозволата за емитовање на Радио Слободна Македонија

Поради необезбедување минимални кадровски услови, обврска од ЗАВМУ и Правилникот за минимални технички, просторни, финансиски и кадровски услови за добивање дозвола за радио или телевизиско емитовање, на Радио Слободна Македонија му беше одземена дозволата за емитовање на национално ниво.



AGJENCIA PËR SHËRBIME MEDIATIKE
AUDIO DHE AUDIOVIZUELE



NEWSLETTER

Mbikëqyrjet ndaj radiodifuzerëve, RRPKE dhe medimeve të shtypit

Radiodifuzerë

Në muajin maj, Agjencia realizoi mbikëqyrje të rregullt programore ndaj radios RFM nga Shkupi për të përcaktuar nëse radiodifuzeri ka implementoi të paktën 80% të konceptit të programit për të cilin i është dhënë leja, gjatë një jave. Analiza një javore e programit të përgjithshëm të transmetuar, që është realizuar në javën e 23-29 prillit, tregoi se ky detyrim ligjor nuk ishte respektuar.

Agjencia realizoi edhe mbikëqyrjen e jashtëzakonshme administrative mbi 34 radiodifuzerë (TV Nova Gevgeli TV Koçani-LD, TV Plus, TV Alfa, TV Tera, TV Zdravkin, TV Sitel 2, TV Skopje, TV Kanal 5, TV Svet, TV M, TV Spektra, TV Anisa, TV Dibra, Plej Radio, Radio Akord, Radio Kiss, Radio Red FM, Radio Expres, Super Radio, Radio Medison, Radio Plus, Radio Fama, Radio Pella, Radio Goldi, Radio Merak, Radio Valandovo, Radio Koçani, Radio La Costa, Radio Modea, Skaj Radio, Radio Zora, Kapitoli FM dhe Radio Ballkan FM) për respektimin e detyrimeve sipas Rregullores për kushtet minimale teknike, hapësinore, financiare dhe kadrovike për marrjen e licencës për transmetim televiziv ose të radios. Mbikëqyrja tregoi se radiodifuzerët i plotësojnë kushtet minimale kadrovike të përcaktuara në këtë Rregullore.

Me qëllim të përcaktimit nëse është vepruar sipas vendimit të dorëzuar paraprak për shqiptimin e masës së vërejtjes, të shqiptuar për shkak të shkeljes së detyrimit për të dorëzuar një formular për strukturën e pronësisë, redaksinë dhe burimet e financimit në vitin 2017, u realizua mbikëqyrje kontrolluese administrative ndaj Skaj Radio Plus. Mbikëqyrja tregoi se Skaj Radio Plus e ka përmbushur në tërësi këtë obligim.

Për shkak të konstatimit të mosrespektimit të obligimit që deri më 31 mars 2018 të dorëzohet raport me shkrim për zbatimin e detyrimeve të përcaktuara në lejen për emetim të radios dhe televizionit ndaj 31 radiodifuzerëve (RA 106, Radio Antena 5, Radio B-97, Radio Balkan FM, Radio Enxhels, Radio Lajf, Radio La Kosta, Radio Pella, Radio Meff, Sky Radio Plus, Radio Maqedonia e Lirë, Super Radio, Radio Universitare UGD FM, TV Drini, TV G-TV, TV Kanal 21, TV Kanal Vis, Nasha TV, TV Orbis, TV Plus, TV Shutel, TV Sitel 2, TV Alsat-M, TV Uskana Një, TV Art Channel, TV Gurra, TV Moris, TV Toepstrada, TV Kaltrina, TV Kobra dhe TV Uskana Media) Agjencia shqiptoi masën e vërejtjes.

Masat e vërejtjes janë shqiptuar ndaj TV Gurra, TV Orbis dhe Skaj Radio Plus dhe për mosrespektimin e detyrimit për të dorëzuar të dhëna mbi strukturën e pronësisë, redaktorin / redaktorët përgjegjës, burimet e financimit në vitin 2017, të hyrat dhe shpenzimet e realizuara në vitin 2017, ndërsa ndaj Radiotelevizionit të Maqedonisë - Radio e Maqedonisë, për shkak të mos publikimit të impresumit.


Operatorët e rrjeteve publike të komunikimit elektronik

Ndaj operatorëve kabllor VIVA NET, KABLE-L-NE, KDS-VT, KOMBO 2003, SIGNAL-NET, MULTIMEDIJA NETWORK dhe TELENET KOM, është realizuar mbikëqyrje e rregullt programore në lidhje me dispozitat ligjore që kanë të bëjnë me detyrimet për regjistrimin e shërbimeve të programeve në Agjenci si dhe për titrimin në gjuhën maqedonase ose gjuhët e bashkësive joshumicë në RM. Mbikëqyrja ndaj KOMBO 2003, SIGNAL-NET dhe TELENET KOM tregoi se operatorët kanë ritransmetuar shërbimeve programore që nuk janë të përfshira me vërtetimet për regjistrim të shërbimeve programore të lëshuara nga Agjencia, për çka janë obliguar për të ç'kyçur nga ritransmetimi shërbimet e kontestueshme programore. Operatorët e tjerë kabllorë kanë vepruar në përputhje me dispozitat e LSHMAA.

Ndaj operatorit kabllor ONE.VIP është realizuar mbikëqyrje e rregullt e programeve në lidhje me dispozitat ligjore për obligimet për veprat kinematografike, mbrojtjen e të miturve dhe promovimin e prodhimit dhe qasjes në veprat evropiane. Me mbikëqyrjen u konstatua se operatori kabllor ka vepruar në përputhje me dispozitat e LSHMAA.

Mediumet e shtypit

Mbikëqyrje kontrolluese administrative në maj është kryer ndaj revistës "Hrana i Vino", me qëllim që të konstatohet nëse botuesi i këtij medium të shtypit ka vepruar sipas Aktvendimit të masës-vërejtje, të shqiptuar për mospublikimin e të dhënave bazë, për redaksinë, të dhënat për shtypshkronjën si dhe datën e botimit ose ribotimit. Me mbikëqyrjen është konstatuar se është menjanuar shkelja e dispozitave të Ligjit për medime. Mbikëqyre kontrolluese administrative është realizuar edhe ndaj Shoqatës kulturore VIZIONI M Shkup, botues i magazines Shenja, me qëllim që të konstatohet nëse ky magazin ka vepruar në pajtim me vendimin për masën-vërejtje, e cila ishte shqiptuar më parë nga Agjencia për shkak të mospublikimit të impresumit. Me mbikëqyrjen është konstatuar se është vepruar plotësisht sipas vendimit të shqiptuar paraprak.



AGJENCIA PËR SHËRBIME MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE

E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

rr. Maqedonia nr. 38, 1000 Shkup

Tel. (02) 3103400 faks: (02) 3103401

e-posta: contact@avmu.mk ueb faqia: www.avmu.mk



MKC EN ISO 9001:2009